



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Departant Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.25/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.72/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija-Kerveshi, Av. nga , si përfaqësues i palës ankuese . me seli në , dhe Përmbaruesi Privat, pas këshillimit dhe votimit me datë 21.11.2023, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-25/2023 i datës 19.09.2023, si dhe ankesa e palës ankuese me seli në e datës 31.08.2023 si të pabazuara.

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr. 72/2022.

Arsyetim

Me datën 31.08.2023, pala ankuese përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit, me pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore, duke tejkaluar autorizimin e tij gjatë kryerjes së detyrave të tij ka shkelur detyrat e parapara me ligj.

Kjo për shkak se përmbaruesi pa kaluar afati për prapësim, ka bërë bllokimin e llogarive bankare të dëbtorëve dhe ka bërë edhe bllokimin e automjeteve të dëbtorëve.

Debitorët kanë parashtruar prapësim brenda afateve dhe kanë njoftuar përmbaruesin, ku është kërkuar nga përmbaruesi lirimi i llogarive, por përmbaruesi nuk ka respektuar afatin ligjor dhe dispozitat ligjore lidhur me këto veprime për këtë rast.

Me këto veprime sipas palës ankuese përmbaruesi ka dështuar që të veproj në harmoni me dispozitatligjore dhe ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367,p.1.1 dhe 1.4 të LPP-së.

Duke u bazuar në këto pala ankuese i ka propozuar komisionit që komisioni të aprovoj ankesën e dëbtorit dhe të ndërmirrën masa ndaj përmbaruesit privat.

Me datën 19.09.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se sa i përket pretendimit të palës ankuese, nuk qëndrojnë sepse përmbaruesi ka vepruar bazuar në dispozitat ligjore.

Në seancën dëgjimore i autorizuari i palës ankuese ka deklaruar se përpos atyre të cekura në ankesë, ka potencuar se përmbaruesi përpos nuk ka pritur afatin për vendosje lidhur me prapësimin, ka bërë dhe bllokimin e llogarive bankare private për debitorët, pa qenë fare peng llogaritë e dëbtorëve, por peng ka qenë vetëm llogaria e biznesit e jo edhe tjerat llogari personale. Përmbaruesi përpos kësaj ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, fillimisht duke mos pritur afatin për prapësim e pas kësaj edhe duke bërë bllokim të llogarive personale pa qenë të regjistruara si peng.

Përmbaruesi privat në seancën dëgjimore në deklaratimet e cekura nga përfaqësuesi i palës ankuese, deklaroi se ka vepruar duke u bazuar në dispozitat e nenit 167 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera sendore e lidhur me nenin 48 të LPP-së, e obligon përmbaruesin që pa kurrfarë njoftimi paraprak të i ndërmarrë veprimet sikurse dhe janë ndërmarrë në këtë rast.

Lidhur me pretendimin që janë bllokuar llogaritë personale për debitorët pa qenë peng, këtë e ka rregulluar, pasi ka vërejtur këtë fakt dhe ka bërë lirimin e llogarive pa pritur vendimin e gjykatës për prapësimin, por kjo ka ndodhur pasi përmbaruesi i është referuar deklaratës së regjistrorit të pengut dhe kur ka vërejtur që në kontratën e pengut nuk ekzistojnë llogaritë personale si peng, ka bërë lirimin e llogarive personale të dëbtorëve.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazon në dokumentin përmbarimor kontratat e kreditë, pengut dhe dokumentacionit lidhur me regjistrimin e pengut.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me karakterin suspensiv të prapësimit, komisioni për këtë pjesë i është referuar dispozitave ligjore konkretisht nenit 47 ,pika 7 të LPP-së dhe dispozitave lidhur me ekzekutimin gjyqësor të pengut ,ku me nenin 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore pika e parë ceket se “ Pengmarrësi i pengut pa posedim mund të paraqesë një kërkesë në gjykatën kompetente, që pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e pengdhënësit apo personave të tjerë atë ta autorizojë që sendin e lënë peng ta sekuestrojë dhe t’ia dorëzojë pengmarrësit. Rreth kësaj kërkesë gjykata duhet të vendosë më së voni pesë (5) ditë pune pas datës së paraqitjes së kërkesës “.

Në pikën e dytë të këtij neni ceket se “Pengdhënësi ose debitori i kërkesës së siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente që të konstatohet se, e drejta e pengut është e pavlefshme tërësisht apo pjesërisht. Nëse gjykata vendos një konstatim të tillë, ajo duhet njëkohësisht të vendosë a do ta abrogojë apo do ta ndryshojë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni , dhe nëse vendos kësisoj, duhet të vendosë nëse pengmarrësi përgjigjet dhe në cilën shumë përgjigjet për dëmin që është shkaktuar përmes vendimit për sekuestrimin apo dorëzimin e sendit të lënë peng tek pengmarrësi.

Kjo pjesë është e rregulluar me Ligj të Veçantë dhe pala ankuese referuar nenit të njejtë pika e dytë do të mundet që të vërtetojë një gjë të tillë dhe të kërkojë edhe kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga organi përmbarimor, nëse do konstatohet se kërkesa e palës për dorëzim të pengut në posedim është e pavlefshme.

Pasi komisioni nuk ka pasur ndonjë provë të tillë sikurse parashihet në pikën 2 të nenit 167 të LPDTS-së e ka pasur të pamundur që të vlerësojë lidhur me faktin se a është ekzekutuar pengu konform dispozitave për ekzekutim gjyqësor të pengut.

Pretendimin e palës ankuese lidhur me bllokimin llogarive personale të debitorëve pa qenë fare të regjistruara si peng në marrëveshjen e pengut, komisioni ka vërtetuar që të njejtat janë liruar nga organi përmbarues, sapo është konstatuar se ato llogari nuk kanë qenë peng.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.25/2023 datë 21.11.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.